



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilapeno/Prodato Received/Delivery	22. 01. 2024	9	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSHTICK	395/2024		119



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1502/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1502/2023, të datës 08.12.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike „ *masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** ankesa A.nr.1502/2023, e datës 08.12.2023, e parashtruar nga ankuesi Anulohet Vërejtja e datës 13.11.2023 sipas numrit të referencës DMMB/DIV3 NR.02/2022 si dhe Vërejtja e datës 13.11.2023 sipas numrit të referencës DMMB/DIV3 NR.02/2022 të shqiptuara ndaj ankuesit, ndërsa, çështja *kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje* te organi i cili i ka nxjerrë aktet administrative të kontestuara.
- II. Obligohet** mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e çështjes, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Nëpunësi civil, (ne tekstin e mëtejme ankuesi), me datë 08.12.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1502/2023, kundër masës disiplinore “Vërejtje” të datës 13.11.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit nga Zëvendësuesesi i Udhëheqesit të Departamentit të Menaxhimit të Mbledhjes së Borxheve, pranë Administratës Tatimore të Kosovës (tutje referuar ATK), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material, respektivisht aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 18.12.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7369/2023, të datës 08.12.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit të ankuesit me Nr.prot.02/959/11 të datës 27.06.2014; Akt emërimit të ankuesit me numër AE.Nr.566/2022 të datës 05.01.2023; Vendimin me Nr.566/2022 të datës 23.12.2022 lidhur me transferimin e ankuesit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës së ankuesit; Komunikimin elektronik të datës 06.01.2023 ndërmjet Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore dhe ankuesit; Komunikimin elektronik të datës 27.11.2023 ndërmjet udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit dhe personave gjegjës në ATK; Vërejtjen me shkrim me numër DMMB/DIV3 NR.02/2022, të datës 13.11.2023, të Zyrtarit të lartë për masat e sforcuara në Departamentin e Menaxhimit të Mbledhjes së Borxheve; Komunikimin elektronik të datës 13.11.2023 ndërmjet udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit dhe personave gjegjës në ATK; Vërejtjen me shkrim me numër reference DMMB/DIV3 NR.02/2022, të datës 13.11.2023, të shqiptuar nga Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Departamentit të Menaxhimit të Mbledhjes së Borxheve; Vërejtjen me shkrim me numër DMMB/DIV3 NR.02/2022, të datës 13.11.2023, të Zyrtarit të lartë për masat e sforcuara në Departamentin e Menaxhimit të Mbledhjes së Borxheve; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.12.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 18.12.2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Komunikimin elektronik të datës 11.01.2023, 19.01.2023, 18.01.2023, 02.02.2023, 02.03.2023, 15.03.2023, 04.04.2023, 25.04.2023, 11.05.2023, 15.05.2023, 06.06.2023, 09.06.2023, 04.07.2023, 10.07.2023, 02.08.2023, 13.09.2023, 04.09.2023, 04.10.2023, 13.12.2023 ndërmjet udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit dhe personave gjegjës në ATK si dhe Shkresën zyrtare me NR.Prot.09-06-3819 të datës 06.10.2023 lidhur me aprovimin e Rregullores së brendshme të ATK-së Nr.03/2023 mbi Procedurat e Organizimit dhe Funkcionimit të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, E-mailin zyrtar të datës 14.01.2024 nga KPMSHCK për ATK-në si dhe E-mailin zyrtar të datës 15.01.2024 të datës nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të ATK-së për KPMSHCK-në.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankuesit të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që ka nxjerrë aktin juridik të kontestuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.566/2022 të datës 05.01.2023, ushtron pozitën e punës “Zyrtar i mesëm i mbledhjes së detyrueshme” në Departamentin për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, Divizioni për Masa të Sforcuara të Mbledhjes.

Tutje, nga shkresat e lëndës rrjedhë së më datë 13.11.2023, Zyrtari referuar si Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, përmes shkresës me numër reference DMMB/DIV3 NR.02/2022, ka shqiptuar ndaj ankuesit vërejtjen me shkrim, mbi bazën e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik për shkelje disiplinore sipas nenit 46 para grafi 3, me shkakun se ankuesi nuk ka zbatuar procedurat komfor Ligjit 03/L-222 për rastet e caktuara nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë ashtu siç parashihen me procedurat e parapara mbi ndarjen e përgjegjësisë (procedurave) në kuadër të DMMB-së, bizneset që kanë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, trajtimi i bizneseve që janë nëpër gjykatë (vendimet nga gjykata), lista e borxheve kritike dhe të vjetra, intervistës fillestare, identifikimin e personave përgjegjës, vlerësimi i përgjegjësive për personat e ndërlidhur si dhe konfiskimi për të cilën në vazhdimësi thekson se janë njoftuar përmes e-

mailave dhe për mos reagimin e apo përmirësimin sipas rekomandimeve dhe mos zbatimin e të gjitha këtyre të gjeturave.

Po në të njëjtën ditë pra më datë me 13.11.2023, Zyrtari Naim Hoxha tani referuar si Zyrtar i lartë për masa të sforcuara, përmes shkresës me numër reference DMMM/DIV3 NR.02/2022 , ka shqiptuar ndaj ankuesit vërejtjen me shkrim, mbi bazën e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, për shkeljet disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, paragrafin 3 nën paragrafin(duke mos përcaktuar këtu paragrafin) me arsyetimin e njëjtë sikurse në vërejtjen e më sipërme.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se masa disiplinore e dhënë mbi bazën e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ka shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe shkelje të ligjit dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, sepse Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik. Me tej ankuesi në ankesë pretendon së masa tjetër e shqiptuar bazuar në dispozitat e ligjit Nr.08/197 për Zyrtarët Publik ka shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe shkelje të ligjit si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, ngase, arsytimi është i pa konkretizuar dhe tërësisht i pa bazë, thekson faktin se në shkresën dhe formën e shkresës shihet se ka shumë lëshime teknike si nga numri i referencës, pa numër protokollit dhe se asnjëherë eprori i tij nuk është konsultuar paraprakisht për çështjen e masës disiplinore. I njëjti nga Këshilli kërkon që masat disiplinore ti anulohet dhe ti hedh poshtë, ngase asnjëra nuk kanë bazë ligjore.

Rrjedhimisht, në kuptim të vlerësimit të kompetencës së organit që ka nxjerrë aktet e kontestuara më ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar të dy masat disiplinore Vërejte që mbajnë datë dhe numër të njëjtë të referencës, gjegjësisht datë 13.11.2023 dhe numër reference DMMM/DIV3 NR.02/2022 dhe të shqiptuar nga zyrtari i njëjtë, po me emërtime të ndryshme të pozitës së punës, përkatësisht në njërin vërejtje është specifikuar si Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, ndërsa në vërejtjen tjetër është specifikuar si Zyrtar i lartë për masa të sforcuara. Përkatësisht, përkundër kërkesës së Këshillit të datës 16.01.2024 drejtuar organit të punësimit, ky i fundit nuk ka përcjell asnjë dëshmi që vërteton pozitën e nëpunësit civil në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit. Gjegjësisht në përgjigjen e datës 17.01.2024 të organit të punësimit është theksuar se: *ndërsa sa i përket pikës se dyte për te ju informuar ne lidhje me pozitën e z. i cili i ka shqiptuar vërejtjet ne cilësi të udhëheqësit të drejtpërdrejt, ju njoftojmë se në mungesë të pozitave Udhëheqës Ekipi i njëjti momentalisht z. kryen detyrën e udhëheqësit.*

Po ashtu nga analizimi i akteve të kundërshtuara me ankesë, Kolegji ka gjetur së masat disiplinore “Vërejtje me shkrim” kanë të bëjnë me shkelje të njëjtë disiplinore pasi që përmbajnë përshkrim tërësisht të njëjtë të pretendimeve për shkeljeve disiplinore nga ankuesi, mirëpo që baza ligjore i referohet ligjeve të ndryshme përkatësisht Ligjit Nr.06/L-114 dhe Ligjit Nr.08/L-197, gjendje kjo që sipas sqarimeve të organit të punësimit të datës 17.01.2024 ka ndodhur si rezultat se citojmë: *“masat disiplinore të cilat janë shqiptuara në bazë të Ligjit Nr.06/L-114, e që në kohën kur janë dhëne këto vërejtje ky ligj ka qenë i shfuqizuar, udhëheqësi që i ka shqiptuar vërejtjet me dispozita ligjore të Ligjit Nr.06/L-114, menjëherë pasi është informuar që ligji i lartë cekur është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për zyrtarët publikë, të njëjtat vërejtje nuk i ka shfuqizuar me arsyetimin se ka ndërruar vetëm baza ligjore, duke i lënë datën dhe protokollin e njëjtë me vërejtjet paraprake që do të thotë në fuqi janë vërejtjet me baze ligjore Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike.* Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit nuk ka mbështetje ligjore ky arsytim i organit të punësimit, pasi që marrë parasysh kohën e shqiptimit të vërejtjeve disiplinore të kontestuara me ankesë, është fakt i pa kontestuar se kemi të bëjmë me shkelje të njëjta disiplinore dhe së me rastin e shqiptimit të masës disiplinore është dashur të aplikohet Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë i aplikueshëm nga data 25.09.2023, mirëpo, që në rastin konkret masa disiplinore e shqiptuar mbi bazën e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë duhej të anulohet në pajtim me dispozitat e nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-




031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse për të njëjtën/tat shkelje disiplinore nuk mund të shqiptohet/en dy masa disiplinore.

Referuar kontestimeve si më sipër, rrjedhimisht duke qenë se aktet e kundërshtuara me ankesë janë të përfshira me të meta ligjore, që pamundësojnë vendosjen meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoj që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, me detyrimin që ky i fundit brenda afatit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit, të bëjë rishqyrtimin e kësaj çështje disiplinore, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi rrjedhimisht të saktësoj kompetencën lëndore të organit dhe në pajtim me dispozitat e nenit 7, paragrafit 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, të bëjë rishqyrtimin e shkeljeve disiplinore të ankuesit dhe pas kualifikimit të shkeljeve të shqiptoj masën disiplinore për shkelje të lehta disiplinore apo çështjen ta procedoj tek Komisioni Disiplinor në rast të pretendimit se ankuesi ka bërë shkelje e të rënda disiplinore, vërtetimi i të cilave bie në kompetencë materiale të komisionit disiplinor.

Theksuar si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1502/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.